



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS

PROCEDURAT DHE MEKANIZMAT PËR TË BËRË KËRKESË DHE ANKESË
QË LIDHEN ME VEPRIMET OSE MOSVEPRIMET E GJYKATËS

(Përfshirë adresën postare/elektronike për depozitimin e kërkesave dhe ankesave-
Afatet dhe mënyrën e kthimit të përgjigjeve)

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrativo-gjyqësore, ndër të tjera investohet në shqyrtimin dhe trajtimin e Kërkesave dhe Ankesave që depozitohen pranë saj nga përdoruesit e gjykatës, në formën e kërkuar nga ligji.

Theksojmë se e drejta e informimit dhe aksesit në Gjykatë janë parimet bazë dhe themelore që udhëheqin veprimtarinë e sistemit gjyqësor, parim i cili parashikohet drejtpërdrejt edhe në **Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë**, konkretisht:

Neni 23

1. E drejta e informimit është e garantuar.
2. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore.
3. Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Gjithashtu, kjo e drejtë parashikohet edhe në **Ligjin Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”**:

Neni 3

E drejta e informimit

1. Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
2. Autoriteti publik është i detyruar të informojë kërkuuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
3. Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.
4. Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji.

Ndërkaq, palët ndërgjyqëse apo çdo përdorues i Gjykatës, në çdo kohë, mund të marrin informacion zyrtar, mund të paraqesin Kërkesë apo Ankesë, përmes **mënyrave të mëposhtme**:

1. **Paraqitja fizikisht- Orari zyrtar i shërbimeve: 08:00 – 16:00**

(informacion pranë Sportelit të Shërbimeve (Seksioni Penal, Seksioni Civil) dhe pranë
Zyrës së Shërbimit Kavajë);

2. Në Këndet e Afishimit (Stenda/Monitore/Njoftimet/informacionet publike)

Në ambientet e hollit të Gjykatës janë të vendosura stenda, kënde dhe monitorë ku publikohen informacione të ndryshme

3. Me shkrim- Nëpërmjet shërbimit postar në adresat fizike

<u>Seksioni Penal (Selia):</u>	Lagjja Nr. 2, Rruga “Aleksandër Goga”, Durrës;
<u>Seksioni Civil:</u>	Lagjja Nr. 14, Rruga “Bajram Tusha”, Shkozë, Durrës
<u>Zyra e Shërbimit Kavajë:</u>	Lagjja Nr. 4, Rruga: “Josif Buda”, Kavajë

4. Nëpërmjet faqes zyrtare e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës (Portalit të Gjykatës)

www.gjykata.gov.al

5. Me e-mail drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

e- mail: zmp.gjykatarrethitdurrës@gjykata.gov.al

6. Me e-mail drejtuar Koordinatorit për të Drejtën e Informimit;

e-mail: abela.lame@gjykata.gov.al

7. Me telefon;

Tel: 00355 52 234362 - Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

Tel: 00355 55 245075 - Zyra e Shërbimit Kavajë

Gjatë trajtimit të kërkesave apo ankesave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse ose çdo përdorues tjetër i Gjykatës Kryetari, Kancelari, Koordinatorit për të Drejtën e Informimit apo çdo nëpunës tjetër përgjegjës, shqyrtojnë kërkesat apo ankesat, sipas parashikimeve ligjore si më poshtë:

- Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar;
- Ligjit Nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Ligjit Nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” (I ndryshuar);
- Vendimit Nr. 150, datë 29.03.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe aktet e tjera të nxjerra prej tij;
- Aktet e tjera ligjore në fuqi.

Për kërkesat që lidhen me kopje të dokumente fizike, që kanë tarifë sipas ligjit, zbatohen tarifat e parashikuara nga:

- Udhëzim i Përbashkët Nr. 33-datë 29.12.2014 “Për tarifat e shërbimit të administratës gjyqësore-Ministrisë së Drejtësisë-Përmbartimit-Prokurorisë-Noterisë”-GJDR-AL

<https://gjykata.gov.al/rrethi-durr%C3%ABs/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-durr%C3%ABs/gjykata/informacion/tarifa-gjyq%C3%ABsore/>

KËRKESA, ANKESA, AFATI DHE MËNYRA E KTHIM PËRGJIGJES

1. KËRKESA:

Sipas Ligjit Nr. 119/2014

Neni 11 KËRKESA PËR INFORMIM

1. Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuarit dhe nënshkrimin e tij. Në çdo rast, kërkesa regjistrohet në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji.
4. Kërkesa për informim duhet të përmbajë:
 - a) emrin dhe mbiemrin e kërkuarit;
 - b) adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
 - c) përshkrimin e informacionit që kërkohet;
 - ç) formatin në të cilin preferohet informacioni;
 - d) çdo të dhënë që kërkuari gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.
5. Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.
6. Përjashtimisht, kërkesat për njohjen me informacionin arkivor të ruajtur në arkivat e përhershëm trajtohen në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”.

1.1 AFATI

Neni 15 AFATI PËR MARRJEN E INFORMACIONIT

1. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.
2. Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë.
3. Afati i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme:
 - a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze;
 - b) nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit;
 - c) nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuarit.
4. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.
5. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të ruajtur në arkivat në veprim.

1.2 MËNYRA E KTHIM PËRGJIGJES

Sipas Ligjit Nr. 119/2014, Neni 11, pika 5 dhe 6

5. Në qoftë se kërkesa për informim nuk e përcakton formatin në të cilin kërkohet informacioni, ai jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik.
6. Përfundimisht, kërkesat për njohjen me informacionin arkivor të ruajtur në arkivat e përhershëm trajtohen në përputhje me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003, “*Për arkivat*”.

2. ANKESA

Sipas Ligjit Nr. 119/2014 Neni 24

PROCEDURAT PËR SHQYRTIMIN E ANKESAVE

1. Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.
2. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:
 - a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
 - b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.
3. Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ia kalon atë strukturës që merret me të drejtën e informimit, e cila verifikon faktet dhe bazën ligjore të ankesës. Për këtë qëllim, ai mund t’u kërkojë ankuesit dhe autoritetit publik, kundër të cilit është bërë ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim, si dhe të informohet nga çdo person dhe burim tjetër. Kur e sheh të nevojshme, Komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve.
4. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi.
5. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos:
 - a) mospranimin e ankesës kur:
 - i) ka kaluar afati i parashikuar në pikën 2 të këtij neni;
 - ii) ankimi nuk paraqitet në formë shkresore;
 - iii) nuk tregohet emri dhe adresa e ankuesit;
 - b) pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit publik për të dhënë informacionin e kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme dhe sipas rastit, propozimin për të deklasifikuar informacion;
 - c) rrëzimin e ankesës, pjesërisht ose tërësisht;
 - ç) afatin, brenda të cilit autoriteti publik duhet të zbatojë urdhrin.
6. Në qoftë se Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk merr vendim brenda afatit të parashikuar në pikën 4, të këtij neni, ankuesit i lind e drejta për t’iu drejtuar gjykatës.
- 6/1. Autoriteti publik është i detyruar të zbatojë vendimin e Komisionerit kur ka urdhëruar dhënien e informacionit të kërkuar, në mënyrë të plotë ose të pjesshme, me përjashtim të rastit kur gjykata vendos pezullimin e zbatimit të tij.
7. Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk cenon kompetencat e Avokatit të Popullit, lidhur me mbikëqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas Ligjit Nr. 8454, datë 4.2.1999, “*Për Avokatin e Popullit*”.

2.1 AFATI

Sipas Ligjit Nr. 119/2014, Neni 24, pika 1 dhe 2

1. Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.
2. Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve pune nga dita kur:
 - a) ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
 - b) ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.

2.2 MËNYRA E KTHIM PËRGJIGJES TË ANKESËS

Sipas Ligjit Nr. 119/2014, Neni 24, pika 4

4. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr vendim për ankesën brenda 15 ditëve pune nga dita kur është dorëzuar ankimi.

3. KU TË ANKOHENI SIPAS RASTIT NË MËNYRË TË PËRGJITHSHME

SITUATA

KU ANKOHENI

Gjykata nuk vepron proceduralisht sipas kompetencës	Fillimisht tek Kryetari i Gjykatës, KLGGJ Gjykata- e- mail: zmp.gjykatarrrethitdurrës@gjykata.gov.al KLGGJ- e-mail donald.jorgoni@klgj.al ose https://klgj.al/kontakt Në Gjykatën/Prokurorinë kompetente, sipas legjislacionit në fuqi, varësisht nga situata
Veprime ose mosveprime , të cilat përbëjnë mospërmbushje të detyrës, apo sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit apo jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE të gjitha niveleve në Republikën e Shqipërisë , e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e Prokurorit të Përgjithshëm, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë.	Shkeljet disiplinore hetohen nga ILD, (Inspektori i Lartë i Drejtësisë) bazuar në Ligjin Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. https://ild.al/sq/si-pranohen-ankesat/paraqit-ankese/ me e-mail në adresën info@ild.al

	me postë në adresën: <i>Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë;</i> Ose fizikisht pranë ILD. Në Gjykatën/Prokurorinë kompetente, sipas legjislacionit në fuqi, varësisht nga situata
Veprime ose mosveprime, jo sipas ligjit, sjellje jo korrekte të Kancelarit	Fillimisht tek Kryetari i Gjykatës, KLGJ Gjykata- e- mail: zmp.gjykatarrethitdurrës@gjykata.gov.al KLGIJ- e-mail donald.jorgoni@klgj.al ose https://klgj.al/kontakt Në Gjykatën/Prokurorinë kompetente, sipas legjislacionit në fuqi, varësisht nga situata
Veprime ose mosveprime, sjellje jo korrekte të nëpunësve civile gjyqësorë, punonjësve të tjerë mbështetës, stafit të administratës gjyqësore të Gjykatës	Fillimisht tek Kryetari i Gjykatës, Kancelari, KLGJ Gjykata- e- mail: zmp.gjykatarrethitdurrës@gjykata.gov.al KLGIJ- e-mail donald.jorgoni@klgj.al ose https://klgj.al/kontakt Në Gjykatën/Prokurorinë kompetente, sipas legjislacionit në fuqi, varësisht nga situata
Ndaj veprimeve/mosveprimeve apo Vendimeve të Këshillit të Gjykatës së Shkallës Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës	Në Gjykatën Administrative të Apelit Adresa: Rruga “Ismail Qemali” 9, Njësia Bashkiake Nr.2, K.P. 1010, Tiranë Email: zmp.administrativeapelit@gjykata.gov.al Në Gjykatën/Prokurorinë kompetente, sipas legjislacionit në fuqi, varësisht nga situata

Veprime/ Mosveprim që çënojnë të drejtat e subjektit/palëve/përdoruesve të gjykatës etj.	AVOKATI I POPULLIT Adresa: Blv. “Zhan D’Ark”, Nr. 2, Tiranë E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al E-mail: koordinatori.informimi@avokatipopullit.gov.al